



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË

SHKOLLA TEKNIKE EKONOMIKE TIRANE

MARRVESHJE BASHKEPUNIMI

Ndërmjet Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë dhe Bashkisë Tiranë
për vitin akademik 2016-2017

Për formalizimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe biznesit, lidhur me përfitimin nga ana e nxënësve të përvojës, në kushtet konkrete të zhvillimit të veprimtarive ekonomike, gjatë kryerjes së praktikave profesionale dhe vizitave në biznes.

Gjatë vitit ushtrimor mësimor, Shkolla Eeknike Ekonomike, në programet mësimore ka të përfshirë edhe zhvillimin e moduleve të praktikave profesionale, si një komponent të rëndësishëm për njohjen dhe aftësimin e nxënësve në situatë reale të punës. Në këtë kuadër, marrëveshjet me partnerë biznesi marrin një vlerë dhe rëndësi të vecantë mbështetëse.

Duke u bazuar në besimin reciprok, palët bien dakort të bashkëpunojnë për sa vijon:

- Realizimin e vizitave ditore të nxënësve me qëllim njohjen e firmës, të shoqëruar nga mësuesit përkatës.
- Realizimin e praktikave profesionale të nxënësve sipas programit të moduleve të praktikës profesionale, që kanë si qëllim zbatimin praktik të njohurive të përfituara nga kushtet e shkollës.
- Dhenie konsulence nga specialistë të sektorëve sipas rastit (shitje, blerje, llogari, marketing, banka, tatimet etj)
- Pajisje të nxënësve me formularë e dokumenta që përdoren realisht me qëllim krahasimin me dokumentat që njihen në shkollë (faturë tatimore shitje, libër blerje, libër shitje, kartelë magazine, listëpagese etj.)
- Reklamimi i firmës dhe produkteve të saj nga nxënësit nëpërmjet shpërndarjes së flet-palosjeve, pyetesorëve, pjesëmarrjes në panairë etj.
- Angazhim të nxënësve në kryerjen e veprimeve të thjeshta ekonomike në ndihmesë të punonjësve të sektorëve të ndryshëm.
- Gjatë kohës së qëndrimit në institucion/firmë nxënësi duhet të zbatojë rregulloren e brendshme të tij.
- Praktikrat e nxënësve pranë institucionit tuaj do të zhvillohen pa pagesë.

Për shkollën Teknike Eknomike

Alfred Bozhiqi
Drejtor



Për institucionin/ biznesin

[Signature]
BASHKIA TIRANË